

VENDIM
Nr.45, datë 18.3.2020

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER”
SH.P.K., NR. 276, SERIA T15, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË, TË
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 37, DATË
18.3.2015.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE- s nr.109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr.40/4 Prot, datë 10.3.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 18, datë 31.1.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 62/6 prot datë 1.2.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k..

- Me shkresën nr. 38/2 Prot., datë 4.2.2020, ERE-s iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 38/3 Prot, datë 18.2.2020, shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k ka përcjellë dokumentacionin e munguar

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

- Shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 276, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të Bordit të ERE-s nr. 37, datë 18.3.2015, me afat 5-vjeçar. Kjo licencë përfundon në datën 18.3.2020.

- Shoqëria “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k, ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

Aplikimi i shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER” sh.p.k., me nr. 276, seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 37, datë 18.3.2015, duke filluar vlefshmerinë e saj nga data 19.3.2020 për një afat 5 vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti